EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT
TË JETËS ME KURSIM

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a., paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jetë me Kursim është kontrata me anë të së cilës, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakord që kundrejt detyrimit të pagimit të primit të sigurimit në favor të Siguruesit, në përputhje me kushtet e sigurimit të përgjithshme ose te veçanta (nëse ka), Siguruesi do të dëmshpërblejë Përfituesin, në masën e parashikuar në këtë kontratë nëse vërtetohet rasti i sigurimit.

1.2 PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME:

1. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të Sigurimit, Kërkesa për Sigurim (deklarata shëndetësore) që i bashkëlidhet atyre, si dhe kushtet shtesë (në rast se kërkohen nga i Siguruari), këtu e më poshtë, do të quhen "Kushtet e sigurimit".
2. Dokumenti që vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit do të quhet "Polica e Sigurimit".
3. Shoqëria e Sigurimit 'SiCRED" do të quhet "Siguruesi".
4. Individi që nënshkruan kontratën e sigurimit në emër të Siguruesit, do të quhet "Ndërmjetës".
5. Personi fizik ose juridik që lidh kontratën e sigurimit me Siguruesin dhe që është përgjegjës për pagesës e primit, quhet "Kontraktuesi".
6. Individi, jeta e të cilit do të sigurohet sipas kontratës së sigurimit, do të quhet "I Siguruari".
7. Individi, që përfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazën e vullnetit të shprehur nga i Siguruari në policën e sigurimit me vdekjen e të siguruarit, do të quhet "Përfitues".
8. Shuma e mjeteve monetare që Kontraktuesi i paguan Siguruesit, në datat e specifikuara në policën e sigurimit, gjatë gjithë periudhës së sigurimit, do të quhet "Prim i sigurimit".
9. Shuma maksimale, që Siguruesi merr përsipër të paguajë në favor të Përfituesit, me vërtetimin e vdekjes së të Siguruarit, do të quhet "Shuma e sigurimit të Jetës".
10. Shuma që Siguruesi merr përsipër të paguajë në favor të të Siguruarit në datën e Maturimit të Policës do të quhet "Shuma për Mbijetesë". Shuma e Mbijetesës është vlera e pagueshme në datën e maturimit të policës së sigurimit.
11. Shuma e mjeteve monetare, që Siguruesi i paguan Përfituesit / të Siguruarit, me vërtetimin e ngjarjes të sigurimit, do të quhet "Përfitim".
12. Vdekja e personit të siguruar si dhe mbijetesa e tij, vërtetimi i së cilës sjell detyrimin e Siguruesit për të paguar përfitimet sipas kushteve të sigurimit do të quhet "Ngjarje e Sigurimit".
13. Vdekja e të Siguruarit që shkaktohet nga mjete të rastit, të dhunshme, të dukshme, të jashtme, të pavarura nga vullneti i të Siguruarit, do të quhet "Vdekje aksidentale".
14. Humbja e Jetës si pasojë e shkaqeve natyrore, duke përjashtuar aksidentet, këtu e në vazhdim do të quhet "Vdekje Natyrore".
15. Mbijetesa e të Siguruarit përtej orës 00.00 të datës së përfundimit të sigurimit do të quhet "Maturim".
16. Kohëzgjatja, për të cilën është në fuqi kontrata e sigurimit, do të quhet "Periudha e sigurimit".
17. Kontrata e sigurimit në të cilën Kontraktuesi nuk paguan primin e sigurimit dhe Siguruesi redukton Shumën për Mbijetesë, në përputhje me primet e paguara deri në atë moment, do të quhet "Policë me Përfitim të Reduktuar".
18. Sasia e mjeteve monetare që Siguruesi është i detyruar të paguajë, në qoftë se kontrata e sigurimit është ndërprerë në përputhje me kushtet e kontratës së sigurimit, do të quhet "Vlerë e Pagueshme". Në asnjë rast në "Vlerën e pagueshme" nuk përfshihet Shuma e Sigurimit të Jetës.

1.3 E DREJTA PËR T'U SIGURUAR

1. Kanë të drejtë të sigurohen sipas kushteve të Përgjithshme të kësaj Kontrate të gjithë personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç por jo më shumë se 55 vjeç në momentin e lidhjes së Kontratës së Sigurimit.
2. Përveç sigurimit të jetës në këtë kontratë mund të ofrohet edhe sigurim shtesë sipas kushteve shtesë të Siguruesit.
3. Si rregull i përgjithshëm periudha e sigurimit është jo më e vogël se 5 vjet.

1.4 PËRFITIMET E PAGUESHME

1. Përfitimi në rast Vdekjeje të personit të siguruar – I paguhet Përfituesit me një pagesë të vetme, me vërtetimin e ngjarjes së sigurimit gjatë periudhës së sigurimit, në masën 100% të Shumës së Sigurimit të Jetës së bashku me Vlerën e Pagueshme të përllogaritur deri në datën e vdekjes;
2. Përfitimi për Mbijetesën e personit të siguruar – Është shuma për mbijetesë që i paguhet të Siguruarit në Datën e Maturimit të përcaktuar në Policën e Sigurimit.

1.5 PËRJASHTIME

Për efekte të kësaj kontrate sigurimi, humbja e jetës e të Siguruarit nuk do të mbulohet nëse ajo vjen si pasojë direkte apo indirekte e:

1. Luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes dhe akte terroriste.
2. Veprimit të armëve të shkatërrimit në masë si armët bërthamore dhe bakteriologjike.
3. Kontaminimit radioaktiv, shpërthimeve bërthamore, përmbytjeve, zhvendosjes së tokës, tërmeteve, shpërthimeve vullkanike.
4. Drejtimit të mjeteve motorrike tokësore, ujore, ajrore, pa qenë i paisur me dëshminë përkatëse të aftësisë, pjesmarrja në ngjitje alpinistike, gjatë fluturimit me avion të çdo lloji (përveç kur udhëton vetëm si pasagjer), arteve marciale, kanotazhit të çdo lloji, hedhjes nga lartësi të mëdha duke qënë i lidhur si dhe gara shpejtësie të çdo lloji.
5. Akte të qëllimshme të kryera nga Përfituesi direkt kundër interesave të të Siguruarit;
6. Vetëvrasjes.
7. Pjesmarrjes së të Siguruarit në veprimtari të paligjshme dhe kriminale, akte kriminale dhe keqdashëse nga persona me të cilët i Siguruari ka konflikte të mëparshme ose kur sigurimi kryhet në rrethana të tilla që favorizojnë pagesën e dëmit;
8. Në rast të pjesëmarrjes së të Siguruarit në sulme apo veprime e kundërveprime të dhunëshme të provokuara me të tretët, përveç kur i Siguruari vepron në kushtet e vetëmbrojtjes a të nevojës ekstreme.
9. Vdekjen si pasojë e ndodhjes së të Siguruarit nën influencën e alkoolit, përdorimit të drogës ose intoksikantëve të çdo lloji.
10. Përdorimit të mjeteve të fluturimit pa motorr, qëndrimit si pasagjer në to, si dhe parashutimit.
11. Përdorimit të lëndëve eksplozive dhe korosive, përveç rasteve kur është në përmbushje të detyrës profesionale.
12. Çdo lloj defekti fizik apo mendor parakzistues, sëmundjeve të njohura, të trajtuara apo të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguruari dhe është pranuar nga Siguruesi.
13. Pasojat e infektimit me virusin HIV, respektivisht SIDA, (Sindromi i Defiçiences Imunitare të Fituar);

Në të gjitha këto përjashtime, përveç pikës 5 të këtij neni, Siguruesi është përgjegjës vetëm për kthimin e kursimeve të akumuluara Kontraktuesit duke përjashtuar interesat nga investimi dhe nuk do të ketë përfitime të tjera të mëvonëshme për t'u paguar.

1.6 DOKUMENTAT PËR VËRTETIMIN E NGJARJES SË SIGURIMIT:

1. Në rast vdekje të të Siguruarit, Siguruesit duhet t'i dorëzohen dokumentet e mëposhtëm:
    a. Njoftimi i Kontraktuesit / Përfituesit / Përfaqësuesit ligjor / Familjarëve apo të afërmve për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit;
    b. Polica e sigurimit;
    c. Kopje të dokumentit të identifikimit;
    d. Vërtetimi i pagesës së primit të fundit;
    e. Çertifikatën e lindjes dhe familjare të të Siguruarit;
    f. Çertifikatën e vdekjes së të Siguruarit, skedën e vdekjes si dhe çdo dokument tjetër shoqërues mjekësor;
    g. Raporti mjekësor për kohën, shkaqet e vdekjes, etj;
    h. Epikrizë mjekësore nga mjeku që e ka kuruar ose mjekuar të ndjerin;
    i. Dëshmi trashëgimie nëse si përfitues të policës janë përcaktuar trashëgimtarët e ligjshëm;

Siguruesi ka të drejtë të kërkojë edhe prova të tjera të nevojshme për vërtetimin e të drejtës për pagesë.
Shpenzimet që kanë të bëjnë me njoftimin e ngjarjes së sigurimit janë në ngarkim të personit që bën njoftimin.

2. Në rast Mbijetese të të Siguruarit:

    Kërkesa me shkrim për përfitimin e Shumës për Mbijetesë.

1.7 TAKSAT DHE TATIMET

1. Të gjitha taksat, të cilat i referohen pagesave të primit, në qoftë se aplikohen, duhet të paguhen nga Kontraktuesi / i Siguruari së bashku me primin përkatës. Të gjitha taksat mbi përfitimet e sigurimit, në qoftë se aplikohen, duhet të paguhen nga i Siguruari / Kontraktuesi / Përfituesi.
2. Shpenzimet lidhur me vizita mjekësore që zhvillohen me kërkesë të Siguruesit, përpara se Kontrata e Sigurimit të hyjë në fuqi apo në rast riaktivizimi të Kontratës së Sigurimit do të paguhen nga Siguruesi.

SHEMBUJ ILUSTRUES (afati i sigurimit - 5 vjet):

Varianti 1 (përkatësisht Femër mosha 50 vjec, Mashkull mosha 50 vjeç). **Kontributi mujor 100 EUR**, Shumë sigurimi jete 5,000 EUR, Afat sigurimi 5 vjet.

a. ***Varianti 2*** (përkatësisht Femër mosha 25 vjeç, 35 vjeç; Mashkull mosha 25 vjeç, 35 vjeç). **Kontribut mujor 30 EUR**, Shumë sigurimi jete 1,500 EUR, Afat sigurimi 5 vjet.
b. ***Varianti 3*** (përkatësisht Femër mosha 25 vjeç, 35 vjeç; Mashkull mosha 25 vjeç, 35 vjeç). **Kontribut mujor 50 EUR**, Shumë sigurimi jete 3,000 EUR, Afat sigurimi 5 vjet.

Në shembullin konkret është supozuar norma e interesit e pandryshuar edhe për vitet e tjerë.

Varianti 1

		Mosha	AFATI	KONTRIBUTI MUJOR	SHUMA E SIGURIMIT TE JETËS	SHUMA MBIJETESË
1	**FEMËR**	**50 VJEÇ**	**5 VJET**	**100 €**	5,000 €	**5,869.61 €**
2	**MASHKULL**	**50 VJEÇ**				**5,726.60 €**

Varianti 2

		Mosha	AFATI	KONTRIBUTI MUJOR	SHUMA E SIGURIMIT TE JETËS	SHUMA MBIJETESË
1	**FEMËR**	**25 VJEÇ**	**5 VJET**	**30 €**	1,500 €	**1,793.69 €**
2		**35 VJEÇ**				**1,790.09 €**
3	**MASHKULL**	**25 VJEÇ**				**1,778.67 €**
4		**35 VJEÇ**				**1,774.46 €**

Varianti 3

		Mosha	AFATI	KONTRIBUTI MUJOR	SHUMA E SIGURIMIT TE JETËS	SHUMA MBIJETESË
1	**FEMËR**	**25 VJEÇ**	**5 VJET**	**50 €**	3,000 €	**2,986.48 €**
2		**35 VJEÇ**				**2,979.27 €**
3	**MASHKULL**	**25 VJEÇ**				**2,955.84 €**
4		**35 VJEÇ**				**2,947.42 €**

Përfitimet :

Në rast të humbjes së jetës së personit të Siguruar, përfitohet nga pasardhësit shuma në kolonën "Shuma e Sigurimit të Jetës" + Fondin e kursyer të akumuluar të investuar deri në datën e ngjarjes së sigurimit. Në rast mbijetese, në datën e maturimit 31.12.2020 përfitohet shuma sipas Kolonës "Shuma për Mbi Mbijetesë"

SHEMBUJ ILUSTRUES (afati i sigurimit - 10 vjet):

a. ***Varianti 1*** (përkatësisht Femër mosha 50 vjec, Mashkull mosha 50 vjeç). **Kontributi mujor 100 EUR**, Shumë sigurimi jete 10,000 EUR, Afat sigurimi 10 vjet.
b. ***Varianti 2*** (përkatësisht Femër mosha 25 vjeç, 35 vjeç; Mashkull mosha 25 vjeç, 35 vjeç). **Kontribut mujor 30 EUR**, Shumë sigurimi jete 3,000 EUR, Afat sigurimi 10 vjet.
c. ***Varianti 3*** (përkatësisht Femër mosha 25 vjeç, 35 vjeç; Mashkull mosha 25 vjeç, 35 vjeç). **Kontribut mujor 50 EUR**, Shumë sigurimi jete 5,000 EUR, Afat sigurimi 10 vjet.

Në shembullin konkret është supozuar norma e interesit e pandryshuar edhe për vitet e tjerë.

Varianti 1

		Mosha	AFATI	KONTRIBUTI MUJOR	SHUMA E SIGURIMIT TE JETËS	SHUMA MBIJETESË
1	**FEMËR**	**50 VJEÇ**	**10 VJET**	**100 €**	10,000 €	**11,412.39 €**
2	**MASHKULL**	**50 VJEÇ**				**10,516.92 €**

Varianti 2

		Mosha	AFATI	KONTRIBUTI MUJOR	SHUMA E SIGURIMIT TE JETËS	SHUMA MBIJETESË
1	**FEMËR**	**25 VJEÇ**	**10 VJET**	**30 €**	3,000 €	**3,571.04 €**
2		**35 VJEÇ**				**3,546.96 €**
3	**MASHKULL**	**25 VJEÇ**				**3,509.65 €**
4		**35 VJEÇ**				**3,487.99 €**

Varianti 3

		Mosha	AFATI	KONTRIBUTI MUJOR	SHUMA E SIGURIMIT TE JETËS	SHUMA MBIJETESË
1	**FEMËR**	**25 VJEÇ**	**10 VJET**	**50 €**	5,000 €	**5,952.93 €**
2		**35 VJEÇ**				**5,910.81€**
3	**MASHKULL**	**25 VJEÇ**				**5,849.42 €**
4		**35 VJEÇ**				**5,814.52 €**

Përfitimet :

Në rast të humbjes së jetës së personit të Siguruar, përfitohet nga pasardhësit shuma në kolonën "Shuma e Sigurimit të Jetës" + Fondin e kursyer të akumuluar të investuar deri në datën e ngjarjes së sigurimit. Në rast mbijetese, në datën e maturimit 31.12.2025 përfitohet shuma sipas Kolonës "Shuma për Mbi Mbijetesë"